

FATOS KONGOLI  
**STINË PANDEMIE**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



FATOS KONGOLI

STINË PANDEMIE

*roman*

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare *dhe* përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

Imazhi në kopertinë: Isaac Hernández “Autoportret”

ISBN 978-9928-327-39-0

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Çdo ngjashmëri me persona, mjedise dhe ngjarje reale është e rastit.*

*Gjithçka në këtë libër është prodhim i fantazisë.*

Autori



## 1.

*Mars 2020*

Burri, shtatlartë, me një kërrusje të lehtë të trupit dhe me flokë të dendur, krejt të thinjur, po rrinte pranë dritares së apartamentit, në katin e tretë të një pallati, ku kishte lindur plot shtatëdhjetë vjet të shkuara. Dhe, tek rrinte duke vështruar jashtë, i mbërriti një telefonatë nga e bija.

Shfaqja e emrit të vajzës, mbi ekranin e celularit, maturante në një gjimnaz të kryeqytetit, i shkaktoi një vërshim adrenaline; nuk e priste. Në të vërtetë,

ai nuk do të habitej dhe aq sikur me këtë rast ta merrte në telefon ish-bashkëshortja, pavarësisht se afro dhjetë vjet të shkuara ishin ndarë; ajo mund ta mbante mend këtë datë, siç mbante mend edhe ai ditëlindjen e saj.

- Si je? - i erdhi nga ana tjetër zëri i së bijës.

- Mirë, - iu përgjigj ai.

Atë çast vetvetiu i hodhi një vështrim orës, akrepat e së cilës shënonin dhjetë paradite.

- Po ti? - e pyeti.

- Unë dhe Ladi deshëm të të bënim një surprizë, - ia ktheu e bija. - Sot ti ke ditëlindjen, apo jo? Është data 8 mars, sot ti mbush shtatëdhjetë vjeç.

- Oh, - ia bëri burri, - nuk e besoja se do ta mbanit mend!

Ai s'mund të thoshte se prej sa kohësh nuk shihej me fëmijët. Dhjetë vjet të shkuara, kur ata ishin ende të vegjël, pas divorcit detyrimisht ishte larguar nga apartamenti i tyre në Tiranë, ku ata vazhdonin të banonin edhe sot e kësaj dite, për t'u vendosur te shtëpia e tij e dikurshme, në një qytezë periferike të kryeqytetit, pranë bregut të lumit, te prindërit e tij tashmë shumë të plakur. Sipas një marrëveshjeje me ish-bashkëshorten, ai shkonte aso kohe rregullisht dy herë në javë për t'u çmallur me të vegjlit. Më tej, me kalimin e viteve, këto takime për arsye të ndryshme, erdhën duke u rralluar.



Burrin e ngacmoi ideja për ta pyetur vajzën se si ishte nëna e tyre, por hoqi dorë. Ngaqë kjo iu duk e kotë, apo ngaqë e bija i ndërhyri. Ajo u ngut t'i shprehte keqardhjen që pikërisht atë ditë, në shtatëdhjetëvjetorin e tij, kur bashkë me të vëllanë i kishin përgatitur një surprizë dhe do të shkonin tek ai, befas gjithçka qe përmbysur. Befas, duke nisur nga ajo ditë, ata do të mbylleshin brenda, të gjithë do të mbylleshin brenda, askush nuk lejohej të nxirrte jashtë as majën e veshit; jashtë përgjonte vdekja, e quajtur Covid-19.

Vajza i tha se nuk donte t'ia zbulonte surprizën, me shpresë se ky izolim absurd nuk do të vazhdonte gjatë dhe ata mund të shiheshin së shpejti. “Ndryshe, - qeshi ajo, - s’na mbetet tjetër veç të shkallojmë!”

## 2.

Xhoda i Marrë vdiq në muajin gusht të vitit '93. Për ata që nuk e dinë se kush është - më saktë se kush ishte Xhoda i Marrë - shënoj shkurtimisht se, si ish-drejtor i rreptë dhe autoritar i shkollës tetëvjeçare të qytezës sonë, dajakun e të cilit e provuan mbi kurrizin e tyre disa breza nxënësish e bashkë me ta edhe unë, ka qenë njeriu që nxiu fëmijërinë time.

Mirë, mund të vëreni ju, po ju vetë kush jeni?

Kjo s'ka pikë rëndësie, as kam qenë e as jam ndonjë person i rëndësishëm, madje më cilësonin

me nofkën “i humburi”. Lidhur me këtë po sqaroj një rrethanë.

Afro tridhjetë vjet më parë, ndoshta nisur nga ca “histori” të miat, që përfliteshin atëherë, dikujt, me profesion gazetar i pavarur, kështu m’u paraqit ai, i hipi të shkruante për mua. Ky ishte një tip rreth të dyzetave, pak a shumë aq sa isha edhe unë vetë aso kohe, domethënë nga viti ’91 i shekullit të kaluar, shtat mesatar, i shëndoshë, barkaliq, me një fytyrë rrumbullake, ku binin në sy sidomos ca dhëmbë të mëdhenj e të dalë në nofullën e sipërme dhe për këtë arsye buzët nuk arrinte t’i mbyllte. Ai erdhi të më takonte në qytezën periferike të kryeqytetit ku banoja, e ku dikur ka pasur një fabrikë çimentoje, qytezë prej nga më pas unë u largova në rrethana të caktuara dhe u riktheva sërish, po në rrethana të caktuara.

Për të shuar kureshtjen e gazetarit të pavarur, që erdhi, pra, enkas për mua, e ftova të shkonim te qebaptorja “Bregu i Lumit”. Atje, klientët i sajdiste pronari i saj, Arsen Mjalti, ish-brigadier në fabrikën e çimentos, për të cilin thuhej se ndërkaq kishte vënë aq shumë para, sa mund të blinte edhe të famshmin hotel “Dajti”.

Kjo nuk na interesonte as mua, as gazetarit të pavarur; u miqësua shpejt kur vumë re se i faleshim një idhulli tjetër të përbashkët: alkoolit. Ai

më shoqëroi në heshtje, gotë pas gotë. Në dopion e katërt të rakisë, unë u çlirova nga fantazmat e mia, e theva heshtjen dhe u tregova i gatshëm t'u përgjigjesha pyetjeve të tij. Ai nuk mbajti asnjë shënim, si duket gjithçka e regjistronte në kujtesë.

E lamë lokalin në pragun e dehjes. Pastaj e përcolla mikun deri te qendra e qytezës; ai mori autobusin urban dhe qysh atëherë nuk e kam parë më. Sapo u ndamë, u kujtova se nuk e kisha pyetur as se si e quanin, por ka shumë të ngjarë që ai të më kishte treguar se si e quanin dhe unë nuk e mbaja mend. Këtë e mësova disa muaj më vonë, kur më thanë se ai kishte shkruar dhe botuar një libër. Mbi mbulesën e këtij libri figuronte emri i autorit: Katos Fongoli!

Për besë, më ishte fshirë tërësisht!

E lexova librin dhe vura re i habitur se ai më paskej pagëzuar Thesar Lumi! Nuk mund të mos vërej se edhe emri, edhe mbiemri janë sajuar prej tij, s'di përse, s'di për ç'arsye. Nga prindërit e mi të ndjerë, që u prehshin në paqe atje ku janë, unë trashëgoj një tjetër emër e një tjetër mbiemër. Sidoqoftë, meqë deshët të mësonit se kush jam unë, parapëlqej të pohoj që në krye se unë jam Thesar Lumi. Për më shumë hollësira, nëse keni kohë dhe dëshirë, gjeni librin në fjalë të gazetarit të pavarur Katos Fongoli.

Të kthehem tani aty ku e nisa, te vdekja e nxirësit të fëmijërisë sime, të të quajturit Xhoda i Marrë.

Në atë muaj të nxehtë gushti të vitit '93, të gjithëve u ra në sy se ai nuk po shihej të rrinte si zakonisht, i ulur nga mëngjesi në mbrëmje te dera e vilës së tij, rrethuar me kangjella të larta, ku vigjilonte me një shufër të madhe hekuri në dorë, si një sfinks tragjik, në pritje t'ia behte me shpurën e vet të horrave përdhunuesi i së bijës, e cila më pas piu helm dhe vdiq. Me këtë shpjegohej edhe çmenduria e mjeranit; ishte i bindur se vajza e tij e vetme, drita e syve të tij, ishte gjallë, ndodhej brenda në vilë dhe nga çasti në çast do të mësynte përdhunuesi.

Nuk ishte parë gjithashtu as nëpër rrugët e qytezës apo në varreza, ku shkonte pranë varrit të së bijës, dhe rrinte duke vështruar fotografinë e saj. Siç shkoja edhe unë, vjedhurazi, duke u kujdesur që aty rrotull të mos dukej Xhoda i Marrë. Po të më gjente pranë varrit të së bijës ai mund edhe të më vriste. Vilma, kështu quhej vajza e marrakut; ka qenë dhe mbetet dhimbja, dashuria ime e përjetshme, që Providenca ma ofroi dhe unë nuk pata sy ta shihja.

Zhdukja nga qarkullimi i Xhodës së Marrë, nuk ra në sy menjëherë, njerëzit zunë të merakoseshin për të disi me vonesë. Mjeku ligjor që u ndodh në banesë bashkë me përfaqësuesit e lagjes, përcaktoi

se ai kishte vdekur të paktën katër ditë më parë. Ata që puna ua solli të futeshin në vilë, thanë se atje të mbyste një erë e rëndë kufome në prishje.

Të pasnesërmen, në varrimin e tij mori pjesë një turmë e madhe. Midis turmës, që e përshkoi në këmbë rrugën nga shtëpia e të mjerit deri në varreza, gjatë gjithë kohës më mundoi një pyetje jo fort e denjë: sa prej atyre që ndiqnin makinën e funeraleve, ashtu si unë, e kishin provuar në kurriz dajakun e atij që po e përcillnin për në banesën e fundit? E njëjta pyetje më vërtitej në kokë edhe gjatë ceremonisë pranë varrit të hapur, ku nuk u mbajt ndonjë fjalim.

Duket se po kjo pyetje po e mundonte në ato çaste edhe dikë tjetër. Tek shihja se si punëtorët e varrimit, me ca litarë e rrëshqitën arkivolin në fund të gropës, dikush më pëshpëriti në vesh:

“Marroku e ka pasur dorën të rëndë... Zoti e faltë! Derisa të më kallin edhe mua në një gropë si kjo, nuk do të harroj ç’kam hequr prej tij sa herë më thërriste në drejtori”.

Ktheva kokën. Ishte ish-brigadieri i fabrikës së çimentos, pronari i qebaptores “Bregu i Lumit”, Arsen Mjalti. Megjithëse një klient i rregullt i tij, nuk kisha ndonjë simpati për të. Mbaja mend vetëm se dikur, në shkollën tetëvjeçare, ndoshta katër apo pesë klasë sipër meje, ai kishte qenë ndër

nxënësit më të prapë të qytezës. Kështu që nuk ia ushqeva bisedën dhe qëndrova i heshtur derisa varri u mbulua dhe u vendosën dy-tri kurora. Kur njerëzit zunë të largoheshin, Arsen Mjalti më bëri një propozim.

- Në qoftë se nuk ke ndonjë ngut për të vajtur diku tjetër, - më tha, - të ftoj të shkojmë nga lokali. Dua të bëjmë një bisedë... Nëse nuk ke kohë tani, mirë, e lëmë për herë tjetër.

E vështrova i habitur. Ç'është e vërteta unë nuk kisha ndonjë ngut për të vajtur gjëkund dhe e vetmja gjë që nuk më mungonte e s'dija ç'të bëja me të, ishte koha. Po ç'dreqin do të bisedonte me mua Arsen Mjalti?

Tek shihja sytë e tij, që më kishin mbërthyer, trurin ma përshkoi një mendim: a mund ta dinte bashkëfolësi im se ai mbante emrin e një hajduti legjendar francez, të quajtur Arsen Lupen? Tekefundit, kjo dilemë dhe mungesa e simpatisë për të, nuk më penguan që ta pranoja ftesën e tij.

Në lokal na shërbeu një tip rreth të tridhjetave. Ky, kushëri i afërt i ish-brigadierit, e zëvendësonte shpesh këtë të fundit, që ndodhte të mungonte për periudha të gjata dhe askush nuk e merrte vesh arsyen. Për shkak të ngushticës së vendit, atje nuk kishte tryeza të zakonshme me karrige për t'u ulur. Kishte vetëm disa nga ato tryezat e larta, pranë

të cilave klientët pinin në këmbë, midis tymit të qofteve dhe duhanit. Duket, për shkak të ceremonisë së varrimit, lokali ishte ende bosh dhe ne shumë vend pranë njëres prej tryezave. Tipi i banakut, me një shenjë të ish-brigadierit, na solli raki, një teke për pronarin, një dopio për mua. Arseni më pyeti nëse dëshiroja të na përgatisnin diçka për të ngrënë dhe unë i thashë “jo”.

Zumë të pinim në heshtje; ai nga pak, unë sipas zakonit tim, në pritje të mësoja se çfarë kërkonte të bisedonte me mua ai burrë te të dyzetepstat, ndoshta ca më shumë, i pashëm, që gëzonte emrin e një hajduti legjendar. Derisa, më në fund, e theu heshtjen. Më pyeti për prindërit, si mbaheshin ata dhe unë i thashë se vazhdonin të plakeshin. Më pyeti me çfarë merresha, dhe unë i thashë se punoja atje ku kisha punuar gjithmonë, në laboratorin e fabrikës së çimentos. Ai vërejti se ajo fabrikë, që prodhonte më shumë pluhur sesa çimento, i kishte ditët të numëruara.

Pak a shumë kjo që biseda që u zhvillua midis nesh atë ditë dhe, më pas, unë më kot vrava mendjen të gjeja përse Arsen Mjalti më kishte ftuar të shkonim te lokali i tij. Që të mësonte se si ishin prindërit e mi dhe me se po merresha unë? Vështirë ta besojë. Arrita në përfundimin se ai njeri, i cili në qytezë përgojohej shumë, ndoshta nga smira e



njerëzve, ngaqë po pasurohej dita-ditës, kushedi se çfarë kishte dashur të më thoshte dhe, në çastin e fundit, qe penduar.

Këtë dyshim timin e vërtetoi një ndodhi. Që të nesërmen e kësaj bisede Arsen Mjalti nuk u pa më as në lokal e as rrugëve të qytezës. Për të shmangur thashethemet e mundshme, familjarë të tij, përfshirë kushëririn zëvendës, u ngutën të sqaronin se ai kishte vajtur për ca punë diku, s' dihej se ku, jashtë shtetit.

Pas pothuaj dy muajsh Arseni u kthye në qytezë, për t' u larguar sërish nja dy muaj të tjerë më vonë. Sa herë kthehej, pashmangshëm ndodhte të shiheshim te lokali i tij. Në këto raste ai vetëm më buzëqeshte në mënyrë enigmatike, derisa një ditë erdhi te tryeza ku po rrija unë, më qerasi me një dopio raki dhe më kujtoi se kishim lënë një bisedë të papërfunduar. Dhe shtoi se dëshironte ta përfundonim atë bisedë. Në çastin e duhur, vërejti, mjafton që unë të kisha dëshirë!

### 3.

*Mars 2020*

I biri, student në vitin e dytë, në një universitet jopublik të kryeqytetit, i telefonoi fill pas vajzës. Burri e mori me mend, ata duhej të ishin bashkë. Edhe i biri i tha se atë ditë kishin dashur të shkonin tek ai, t'i zbulonin një surprizë, dhe shprehu keqardhjen që kjo doli e pamundur. Ashtu si e motra, shpresonte që ky ngujim të përfundonte shpejt, dhe ata të mund të takoheshin, dhe të festonin shtatëdhjetëvjetorin e lindjes së tij.

“Me sa kam dëgjuar, - qeshi djali, - ditëlindjet është ters t’i festosh përpara datës së caktuar, por s’ka asgjë të keqe t’i festosh edhe disa ditë më pas.”

Për t’i dhënë zemër të birit, burri shprehu gjithashtu bindjen se do të takoheshin shpejt, se kjo gjendje nuk do të zgjaste shumë, i sigurt për të kundërtën. Mbyllja sapo kishte nisur në të gjithë botën, në disa vende njerëzit po vdisnin frikshëm, veçanërisht moshatarë të tij, të cilët me sa dukej ishin më të rrezikuarit. Doemos edhe vajza, edhe i biri duhej ta dinin këtë fakt dhe kërkonin, nga ana e tyre, t’i jepnin zemër. Ndërsa e bija nuk i kishte dhënë ndonjë këshillë, djali iu lut të rrinte brenda. Nëse nuk i ndodheshin ushqime, do ta gjente ai një mënyrë për t’i ardhur në ndihmë.

Burri i tha të mos merakosej, hëpërhë atij nuk i mungonte asgjë; në çdo rast do të mundohej të rregullohej vetë. Me kaq përfundoi edhe biseda me të birin dhe kur ky mbylli telefonin, ai mendoi se pranë fëmijëve, pa dyshim, duhej të ndodhej edhe ish-bashkëshortja. Një copë herë vazhdoi të qëndronte pranë dritares, duke vështruar jashtë me një dëshirë të çuditshme që t’i mbërrinte ndonjë sinjal tjetër. Më kot, nuk i mbërriti asnjë sinjal. Ndoshta ajo priste që ta merrte ai. Ndoshta!

Në rrugën kombëtare përpara pallatit nuk lëvizte asnjë makinë, s'dukej këmbë njeriu. Përtej saj dergjeshin si varr i hapur gërmadhat e një lagjeje të shembur dhe, pranë gërmadhave, makineri të rënda për pastrimin e tyre, të mbetura në tako, siç thuhet, pikërisht kur sapo kishin filluar punën. Ardhasakë, kështu u quajtën në qytezë ata që nisën të vendoseshin atje, në një truall publik, qysh nga fillimi i viteve '90 të shekullit të kaluar. Për rrjedhojë, ajo lagje zuri të njihej me emrin lagjja e "Ardhasakëve". Kjo, për të bërë një dallim midis tyre dhe banorëve që e braktisnin qytezën, pra që iknin, domethënë ikanakët. Ndryshe, emigrantët.

Sidoqoftë, ndarja në ardhasakë dhe ikanakë ishte konvencionale dhe jo fort e saktë. Në atë truall, tërë gropa e plehra, që vinin e i derdhnin atje fshehurazi, natën, nga anë e anës, me kohë, përveç ardhasakëve të mirëfilltë, nëse do të quheshin kështu banorët nga veriu apo jugu i vendit të vendosur aty, kishin ndërtuar shtëpi ose objekte të tjera, sigurisht pa leje, edhe ikanakë të rikthyer në qytezë. Këta, pasi kishin punuar për vite e vite si emigrantë nëpër Europë ose gjetiu. Dhe shumë shpejt ra në sy dukuria e vjetër.

Radhët e ikanakëve zunë të shtoheshin nga ardhasakët, që trashëguan prirjen për t'ia mbathur. Kështu që braktisja e qytezës nuk merrte fund kurrë. Ajo u bë më e fortë pasi një ditë prej ditësh, pas

nja tridhjetë vjetësh, shteti u kujtua të vinte rregull; e gjykoi me vend t'i dëbonte nga ai truall publik, dikur plot gropa e plehra, si ardhacakët e mirëfilltë, ashtu dhe ikanakët e dikurshëm, të vendosur tashmë atje si ardhacakë.

Tek rrinte i mbështetur pas dritares, i përpirë nga këto mendime, atij iu bë sikur dëgjoi britma njerëzish. Dhe zhurma. Britmat ishin prodhim i trurit të tij, zhurmat reale. Në ato çaste, në rrugë kaluan në varg disa makina policie, pas tyre mjete ushtarake me armatim të rëndë, dhe ai u habit; ky demonstrim force iu duk idiotësi. Mendoi se pak çaste më parë e bija kishte pasur të drejtë kur i qe ankuar se po të zgjaste shumë kështu, rrezik të luanin mendsh!

Pati një impuls rebelimi: të dilte nga apartamenti, të zbriste shkallët, të vendosej në trotuarin buzë rrugës dhe, nëse makinat e policisë dhe mjetet ushtarake me armatim të rëndë, në vazhdim të demonstrimit të forcës, do të kalonin prapë andej, t'i përshëndeste me atë gjestin që, para ca kohësh, një diplomat i lartë i huaj, kishte përshëndetur një turmë protestuesish.

Nuk iu dorëzua këtij impulsi. Në vend të kësaj, si u vërtit një copë herë nëpër dhomë si ari i plagosur, e mblodhi se për të qetësuar veten, veprimi më i

arsyeshëm që duhej të kryente ishte të dëgjonte muzikë.

Mbi tryezën e tij të punës, përveç një laptopi, ndodhej edhe një mbajtëse librash, ku renditeshin DVD me filma dhe DVD me pjesë muzikore. Midis këtyre të fundit, të dhuruara më së shumti nga ish-bashkëshortja, zgjodhi atë që atyre u kishte pëlqyer ta dëgjonim bashkërisht më shpesh: *Sonatën e Hënës*, të Beethoven-it.

E nxori me kujdes DVD-në nga mbajtësja, me po aq kujdes e vendosi te një lloj magnetofoni, më i sofistikuar se të zakonshmit, njëherazi edhe radio, dhe e ndezi. Sapo zunë të çliroheshin tingujt e pianos, ai u mbështet pas shpinës së kolltukut dhe mbylli sytë.

“Sigurisht, fati deshi të takohesha me ty”,  
mërmëriti i përhumbur.

#### 4.

Arsen Mjalti e mblodhi ta kryente bisedën e papërfunduar me mua nga tetori i vitit '96, domethënë pas rreth tre vjetësh! Kuptohet, unë e kisha harruar fare këtë mesele. Edhe kur më të rrallë më vinte ndër mend, nuk e përfytyroja se çfarë mund ta lidhte ish-brigadierin e fabrikës së çimentos, të shndërruar në zengjin, me një si unë, që me plot gojën mund të konsiderohej parazit; ato kohë, pas mbylljes së fabrikës, i mbetur pa punë, jetoja mirëfilli në kurriz të prindërve dhe e mbanim frymën me pensionet e tyre mizerabël.

Ndërkaq, prej disa muajsh, Arseni ishte larguar nga qyteza, familjarisht, për t'u vendosur, siç flitej, në Tiranë, në një shtëpi që askush nuk e dinte ku ndodhej, a thua se kërkonte të shkëpuste çdo lidhje me qytezën dhe banorët e saj. Nga ana e tyre, për kompensim, këta nuk munguan ta cilësonin me llojlloj epitetesh. Mirëpo, kur nuk pritej, një pasdite ai ia behu në qytezë, me një *Benz* të zi, nga ata që kisha dëgjuar të quheshin “presidencialë”. E ngiste vetë, dhe ndaloi përbri qebaptores “Bregu i Lumit”.

Unë u ndodha në lokal. E dinin të gjithë se kur shkoja atje ngulesha pothuajse gjithmonë tek e njëjta tryezë, pranë dritares së vetme të asaj kthine. Nuk më pëlqente shoqëria e të tjerëve, qoftë edhe përpara një gote me raki. Nëse lokali ishte plot dhe ndonjë klient, zakonisht kalimtar në qytezë, që nuk i dinte huqet e mia, vendoste të vinte tek unë, nuk e zgjasja, largohesha.

Mbërritjen e *Benzit* e ndoqa nga dritarja. Edhe shfaqjen e papritur të Arsenit. Të pranishmit, përmes derës së hapur panë tërë kureshtje të zbriste nga ajo makinë e zezë një burrë trupmadh, veshur shik, me kostum ngjyrë blu të çelur dhe kravatë të gjelbër. Sapo hyri në lokal ai u dha një përshëndetje të gjithëve dhe vajti drejt e te kushëri i tij në banak. Diçka bisedoi me të, për pak minuta. Pastaj erdhi pranë tryezës ku po rrija unë.



- Kemi lënë një bisedë bashkë, - më tha, - kam ardhur sot këtu posaçërisht për ty, ta përfundojmë bisedën. Nëse je dakord, sigurisht!

Ai fliste me zë të ulët, aq të ulët sa askush të mos e dëgjonte. E ndieja, veshët e të gjithëve rrinin përpjetë, të drejtuar nga tryeza jonë, prandaj nuk e zgjata.

- Mirë, - i thashë, - po të dëgjoj.

- Jo këtu, - ma ktheu ai, - do të shkojmë diku tjetër.

Dhe dolëm nga lokali. Për herë të parë m'u dha rasti të zija vend në një të ashtuquajtur "presidencial". Brenda makinës vinte era e një parfumi të këndshëm, i njëjti që çlironte edhe vetë Arseni. Gjithçka po më dukej e dyshimtë. Si të ma kishte lexuar mendimin, kur makina u vu në lëvizje dhe mori rrugën drejt Tiranës, ai më tha:

- Me siguri ti po vret mendjen të gjesh se ç'punë kam unë me ty!

- Jo, - e gënjeva, - nuk e vras mendjen fare.

Ai qeshi.

- Dëgjo, - vërejtji tek vështronte përpara, - ti mund të mos e dish, por unë të çmoj shumë, kupton?

Meqë unë s'fola, ndërsa makina rrëshqiste mbi asfalt, ai vazhdoi:

- Mund të mos e besosh, por një herë e një kohë të kam pasur zili. Ti ishe student, ndërsa unë punoja

me tri turne te mullinjte e fabrikës së çimentos. Ç'të them, historitë e tua janë te libri i atij gazetarit të pavarur, si pretendonte ai, sepse ku dreqin ekzistojnë këta të pavarur, por tjetër muhabet ky... Pra, të kam pasur zili, derisa ndodhën ato që ndodhën, dhe ai birboja, me të cilin u dendët me raki tek unë, ç'është e vërteta, në librin e tij, që unë e lexova me qejf, e ka përshkruar mirë ç'ke hequr ato kohë, aq sa edhe tani më vjen keq për ty.

Ai heshti pak.

- E di? - vërejti. - Unë dhe ti kemi pasur diçka të përbashkët: ty vazhdimisht të kanë tallur me llojlloj nofkash, ndërsa për mua çfarë nuk flitej. Ti e di çfarë flitej, madje edhe çfarë flitet për mua. Le të lllapin, s'më bëhet vonë! Në sytë e mi ti ke qenë dhe mbetesh një djalë qyteze, me ndryshimin se ke qenë dhe je më i ndersmi.

“Arsen, - thashë me vete, - bjeri shkurt, burrë i dheut, ç'do prej meje?”

Këtë ma shpjegoi pas pak, kur ndalua te një lokal përbri rrugës, që të çonte në Tiranë, dhe me të zënë vend në një tryezë më drejtoi pyetjen më të papritur. Ai deshi të mësonte nëse kisha qenë ndonjëherë te hotel-restoranti më i ri në kryeqytet, me emrin e çuditshëm “Kondor”.

E vështrova i hutuar, pa e marrë me mend se ku donte të dilte. I thashë se e kisha dëgjuar vetëm

si emër, se ishte një hotel luksoz, diku në Tiranë, s'dija se ku, e që më kishte bërë përshtypje sepse Kondor, kaq gjë e dija, ishte emri i një shpendi në vargmalet e Andeve, në Amerikën Latine.

- Me këtë shpend lidhet edhe një melodi mjaft e njohur, - thashë, - e ndoshta kjo mund të jetë arsyeja përse pronari mund ta ketë quajtur kështu; ndonjë kujtim që lidhej me këtë melodi, apo ku ta dish se çfarë. Shqiptar është pronari, apo i huaj?

- Më dëgjo me kujdes, - ma preu vrullin befasi Arseni, - dhe gjithçka të mbetet midis nesh! Mirë? Shumë shpejt, ai hotel tepër luksoz, siç e the edhe ti, do të bëhet i imi. Formalitetet e shitblerjes kanë marrë fund dhe, me kismet, Viti i Ri do të më gjejë atje. Propozimi im është ky: a je i gatshëm të vish të punosh me mua? Përgjigjen nuk e dua tani. Ama mund të të pres vetëm një javë, më tej zëre se nuk e kemi bërë këtë bisedë.

Mbeta i shtangur.

- Atje do të kem nevojë për një si ti, - sqaroi Arseni, - për një njeri që e njoh mirë dhe i besoj... Të tjerat i bisedojmë nëse ti më jep një përgjigje pozitive brenda afatit që të thashë.

E tepërt të bëja naze, pranova në vend. Në gjendjen time prej të papuni, propozimi i Arsenit më erdhi si një dhuratë nga qielli. Atë çast trurin ma përshkoi profecia e banorëve të qytezës, sipas të

cilëve ish-brigadieri i fabrikës së çimentos, pronari i qebaptores “Bregu i Lumit”, kishte bërë aq para sa së shpejti do të mund të blinte të famshmin hotel “Dajti”. Në vend të këtij të fundit, Arseni po blinte një tjetër hotel, që nuk trashëgonte famën e të parit, por që mbante emrin e një shpendi të familjes së shqiponjave, dhe vlente miliona. Shumë që unë nuk u bëra kureshtar ta merrja vesh se sa kishte qenë. Kureshtje pa vend!

Kur gjithçka u bë fakt i kryer, në qytezë shpërthyen komentet. Sipas disave, e vërteta qëndronte ndryshe. Pronari i atij hoteli me pesë yje nuk ishte lapangjozi nga qyteza, Arsen Mjalti, që po merrte poza prej bosi. Prapa tij fshiheshin të tjerë njerëz të fuqishëm, në sferat e larta të politikës, brenda e jashtë vendit, dhe ai ishte thjesht një xhol në shërbim të tyre.

Të tjerë, përkundrazi, e hidhnin poshtë këtë hamendje. Arsen Mjalti ishte pronari i vërtetë i hotelit, blerë prej tij me para të vëna përmes trafikut të drogës. Kështu shpjegoheshin edhe udhëtimet e shpeshta e të dyshimta jashtë shtetit prej disa kohësh të ish-brigadierit, kur ai paskej udhëtuar deri në Kolumbi.

Këto hamendje, mua më hynin te njëri vesh e më dilnin nga tjetri. U prira të besoja se gjithçka përflitej, ishte shprehje e një smire të zezë

provinciale. Dhe nga mesi i dhjetorit, në prag të Vitit të Ri '97, shkela për herë të parë te hoteli me emrin e pazakontë “Kondor”.

Në atë fillim nisesha për në Tiranë në mëngjes herët, me autobusin e parë urban. Në qytezë kthehesha mbrëmjeve vonë, shpesh me autobusin e fundit. Arsyeja: t’u gjendesha prindërve; së paku netët t’i kaloja në shtëpi.

Pleqtë nuk mund të ndiheshin të qetë, nuk do të vinin gjumë në sy nëse unë, para se të shkoja në dhomën time për të fjetur, nuk do të fusja kokën në kuzhinë, ku ata rrinin pranë njëri-tjetrit ulur te një kanape e vjetër, përballë televizorit, për t’u thënë “natën e mirë”. Një rit që e respektoja si diçka të shenjtë. Siç respektoja edhe ritin tjetër, në mëngjes herët, para se të dilja nga shtëpia, kur fusja kokën në kuzhinë dhe ata i gjeja sërish të ulur pranë njëri-tjetrit te kanapeja e vjetër, të thuash se gjithë natën kishin qëndruar aty, kësaj here duke pirë kafënë e mëngjesit. Pleqtë kishin hequr dorë nga ftesat që më bënin për të pirë një kafe me ta; e dinin se kafënë unë do ta pija në klub. Atyre u mjaftonte të fusja kokën dhe para se të dilja nga shtëpia t’u thosha “mirëmëngjesi”.

Kjo rregullsi u prish me të nisur trazirat e atij viti çmendurie '97, kur njerëzit humbën gjithçka nga

shembja e të ashtuquajturave shoqëri piramidale. Kësaj katrahure nuk i shpëtuan as banorët e qytezës. Nga tërbimi, një ditë ata thyen depon e armëve të një reparti aty rrotull, ku unë kisha kryer gjithmonë zborin ushtarak. Në të katërta anët zunë të dëgjoheshin shkrehje armësh, shpërthime bombash, ditën dhe natën, tek ecje në punën tënde mund të haje ndonjë plumb qorr, si ndodhte jo rrallë. E njëjta pamje edhe në Tiranë.

Përtëmbrojtur hotelin nga plaçkitjet e mundshme, Arseni ia doli të merrej vesh me autoritet përkatëse dhe ngriti një grup të armatosur, të gatshëm për çdo të papritur. Ndërsa mua më sugjeroi t'i ndërprisja vajtje-ardhjet në qytezë, të vendosesha në një mjedis të hotelit, derisa të qetësoheshin gjakrat, madje më tha se po të doja mund të më siguronte një revolver për vetëmbrojtje.

Sugjerimin për t'u vendosur në hotel e pranova, atë të revolverit jo. Prindërve u shpjegova se, hëpërhë, nuk do të kthehesha çdo mbrëmje në shtëpi. Që ata të mos ndiheshin vetëm, të mos kishin frikë nga ç'po ndodhte, pajtova një grua.

Bedrija, kështu e quanin gruan, ishte rreth të pesëdhjetave, punëtore pastrimi në shkollën tetëvjeçare të qytezës. Mbetur e ve nga vdekja para pak kohësh e bashkëshortit të saj, me katër fëmijë, relativisht të rritur, por asnjëri në marrëdhënie